



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1095/Prot.

Tiranë, më 05/11 /2015

**Lënda :** Në lidhje me kërkesën për verifikimin paraprak të ligjshmërisë së procedurës së prenotimit online.

**Drejtuar:** SGS Automotive Albania sh.p.k

**Z. Alexandros MICHAIL**

**Drejtor Menaxhues**

**Adresa:** Rruga "Irfan Tomini", Pallati G&B, Kati 2

**Tiranë**

Zyra e Komisionerit, ka marrë në shqyrtim kërkesën tuaj për mendim në lidhje me ligjshmërinë e procedurës së prenotimit online të kontrollit teknik të mjeteve rrugore dhe në këtë kuadër lutemi, referohuni në interpretimin ligjor përkatës.

Sa i përket procesit të konfirmimit të prenotimit, Zyra e Komisionerit vlerëson se zgjedhja/plotësimi i e-mailit apo numrit të telefonit të jetë opsionale, duke i lënë mundësinë aplikuesit të zgjedhë mënyrën e marrjes së njoftimit për aplikim, në bazë të parimit të mjaftueshmërisë së të dhënave (neni 5/1/c i Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar). Qëllimi mund të arrihet qoftë nëpërmjet e-mailit qoftë nëpërmjet numrit të telefonit ose aplikuesi mund t'i zgjedhë të vendosë të zgjedhë të dyja.

Pëlqimi i aplikantit duhet të lërë gjurmë në sistem, në mënyrë që të jetë i provueshëm. Zyra e Komisionerit vlerëson se, pëlqimi i subjekteve të të dhënave personale është shumë i rëndësishëm në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale. Për këtë arsye vlerësojmë se pëlqimi i aplikantëve për t'u njoftuar në lidhje me ndryshimet e legjislacionit, duhet të jetë i ndarë nga pëlqimi për të kryer prenotimin pasi edhe qëllimet e përpunimit janë të ndryshme.

Me qëllim garantimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, është shumë e rëndësishme që klientët/aplikantët të informohen nëse ka përhapje të dhënash personale, ku, si, për çfarë qëllimi, për sa kohë mbahen të dhënat, si do shkatërrohen pas kalimit të afatit dhe nga

kush (SGS apo marrësi i të dhënave) dhe si garantohet siguria e tyre (referuar nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar).

Gjithashtu, përhapja e të dhënave duhet të bazohet në një akt ligjor ose nënligjor, apo të sanksionohet në një marrëveshje ndërmjet palëve në të cilën të parashikohen detyrimet ligjore për sa i përket mënyrës së përpunimit, qëllimi i ligjshëm i përpunimit, masat e sigurisë dhe afati i mbajtjes së të dhënave, në kuadër të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Referuar pikës 6 të “Njoftimit për subjektet e të dhënave personale”, vlerësojmë se të dhënat personale të dhëna nga klientët me qëllim aplikimin për kolaudim automjeti nuk mund të bëhen publike në asnjë rast dhe nga asnjë institucion publik ose privat për sa kohë subjekti i të dhënave personale nuk ka dhënë pëlqimin, ose publikimi nuk bëhet për një interes publik ose nëse nuk legjitimohet nga akte ligjore dhe nënligjore (nenit 6 i ligjit nr. 9887).

Referuar pikës 12 të “Njoftimit për subjektet e të dhënave personale”, vlerësojmë se në zbatim të nenit 5/1/d të ligjit, duhet të përcaktoni një afat konkret për mbajtjen e të dhënave personale (të mos jetë afat i pacaktuar), i cili të reflektojë përputhshmërinë me qëllimin e përpunimit.

Së fundmi, ju informojmë se në kuadër të ndryshimeve që parashikoni të kryeni (siç edhe keni deklaruar) reflektimet përkatëse në formularin e njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit, bazuar në nenet 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

**Besnik DERVISHI**

